



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 651 Akti

Nr. 791 Vendimi  
Tiranë, më 3.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 3.9.2024, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Besnik Maho**, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Maho, për t’u dorëhequr nga procesi i rivlerësimit dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Besnik Maho, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ka kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar për të tria kriteret e rivlerësimit.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 714, datë 15.11.2023, vendosi: “*Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për kërkuuesin Besnik Maho*”, me arsyetimin se kërkuesi nuk ka punuar për një periudhë 3-vjeçare në detyrën e gjyqtarit sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës.
3. Kundër vendimit të mësipërm të Komisionit, Komisioneri Publik dhe kërkuesi paraqitën ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
4. Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendimin nr. 21, datë 13.5.2024, vendosi: “*1. Prishjen e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. 2. Urdhërimit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar për kërkuuesin Besnik Maho, ish-gjyqtar*”, me arsyetimin se ankuesi Besnik Maho përmbush kriterin ligjor të vjetërsisë të paktën 3 vjet të ushtrimit të detyrës si gjyqtar.
5. Pasi çështja u rikthye nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.6.2024, vendosi: “*1. Të vijojë procedurën e rivlerësimit kalimtar për ish-gjyqtarin Besnik Maho sipas kërkesës së tij; 2. Të administrojë nga ILDKPKI-ja raportin e rivlerësimit të pasurisë për ish-gjyqtarin Besnik Maho sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; 3. Të administrojë nga KLGJ-ja raportin e vlerësimit të aftësive profesionale për ish-gjyqtarin Besnik Maho, sipas parashikimeve të neneve 42 e 43 të ligjit nr. 84/2016; 4. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit Besnik Maho për fillimin e hetimit administrativ dhe t'i dërgojë pyetësorin standard lidhur me procesin e rivlerësimit*”.
6. Në datën 26.6.2024, përmes postës elektronike<sup>1</sup>, Komisioni njoftoi z. Besnik Maho (në vijim subjekti) se po vijon me procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Gjithashtu, i kërkoi subjektit: (i) *Të deklarojë nëse ka konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues; (ii) Përgjigjet e pyetësorit bashkëlidhur; (iii) Të deklarojë nëse i qëndron përgjigjeve të pyetësorëve të administruar gjatë procesit të rivlerësimit të personit të lidhur, subjektit të rivlerësimit/znj. A. M., për kriterin e pasurisë, pjesë e dosjes administrative të procesit të rivlerësimit.*
7. Në vijim, Komisioni, në datën 1.7.2024, përmes postës elektronike<sup>2</sup>, i ka kërkuar subjektit të konfirmojë marrjen e njoftimit të datës 26.6.2024. Në përgjigje, subjekti, në datën 2.7.2024, përmes postës elektronike<sup>3</sup>, ka njoftuar Komisionin se: “*...e kam marrë email-in e dërguar dhe ju kam dërguar qëndrimin tim me postë*”.

<sup>1</sup> Email datë 26.6.2024, “Komisioni - Njoftim mbi vazhdimin e procesit tuaj të rivlerësimit”.

<sup>2</sup> Email datë 1.7.2024, “Komisioni - Njoftim mbi vazhdimin e procesit tuaj të rivlerësimit”.

<sup>3</sup> Email datë 2.7.2024, “Re: Komisioni - Njoftim mbi vazhdimin e procesit të rivlerësimit tuaj”.

**8.** Në datën 4.7.2024, shërbimi postar ka dorëzuar në protokollin e Komisionit<sup>4</sup> kërkesën e datës 28.6.2024 të z. Besnik Maho, me objekt “Dorëheqje nga procesi i rivlerësimit si ish-gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”, me bazë ligjore neni 56 i ligjit nr. 84/2016.

**9.** Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kërkesës së mësipërme, kërkuesi, ndërmjet të tjerave, pasi pasqyron kundërshtimet lidhur me vendimin nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit dhe vendimin nr. 21, datë 13.5.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është shprehur se shqyrtimi i kërkesës së tij për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtar nga i njëjti trup gjykues i Komisionit nuk mund të vijojë, sepse ekziston si elementi objektiv dhe subjektiv që kanë të bëjnë me një proces administrativ tërësisht të njëanshëm dhe në përfundim të kërkesës shprehet se kërkon “Dorëheqje nga procesi i rivlerësimit si ish-gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

**10.** Mbledhja e Komisionerëve e datës 8.7.2024, bazuar në përmbajtjen e kërkesës (brendinë e saj), vlerësoi se kërkesa e mësipërme duhet trajtuar si kërkesë për konflikt interesi nga një tjetër trup gjykues. Në vijim, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2024, Komisioni vendosi ngritjen e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës së subjektivit të rivlerësimit Besnik Maho, të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Genta Tafa (Bungo) dhe Valbona Sanxhaktari.

**11.** Në vijim, Komisioni, përmes postës elektronike<sup>5</sup>, i kërkoi subjektivit të saktësojë formalisht qëndrimin e tij, objektin dhe bazën ligjore, në lidhje me konfliktin e interesit me dy prej anëtarëve të trupit gjykues, që ka përmendur në arsyetimin e kërkesës për dorëheqje.

**12.** Në përgjigje, subjekti, përmes postës elektronike<sup>6</sup>, saktësoi se konflikti i interesit me shumicën e anëtarëve të trupit gjykues qëndron në: (1) mungesën e vullnetit nga ana e shumicës së trupit gjykues për t’i njohur jo më pak se 3 vite pune si ish-gjyqtar për t’u rivlerësuar; (2) mosriçeljen e hetimit administrativ; (3) mungesën e arsytimit në vendimin nr. 714, datë 15.11.2023, të shumicës së trupit gjykues; (4) mosdhënien e përgjigjeve të kërkesave të tij për shkeljen e parimit për një proces të rregullt ligjor në vendimin e datës 13.5.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**13.** Trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Genta Tafa (Bungo) dhe Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për njëanshmërinë e trupit gjykues që po shqyrtonte kërkesën e tij për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtar dhe me vendimin e datës 12.7.2024 vendosi rrëzimin e kërkesës. Ky vendim iu njoftua subjektivit përmes postës elektronike<sup>7</sup>.

**14.** Në vijim, Komisioni, në datën 26.7.2024, përmes postës elektronike<sup>8</sup> e ka ftuar z. Besnik Maho për të shprehur vullnetin e tij të pavesuar për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit në seancë dëgjimore dhe nëse nuk dëshiron të paraqitet, ta shprehë edhe një herë vullnetin e tij nëpërmjet postës elektronike.

**15.** Në përgjigje, në datën 27.7.2024, z. Besnik Maho, përmes postës elektronike<sup>9</sup>, ka deklaruar se: “Vullnetin tim të lirë dhe të pavesuar, por që nuk pasqyrohet asnjëherë tërësisht në vendimmarrjet që janë marrë dhe do të merren, lidhur me kërkimet/qëndrimet që unë mbaj, është i plotë dhe shterues si në kërkesën me shkrim të datës 26.6.2024, ashtu edhe në email-in

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2024.

<sup>5</sup> Email datë 9.7.2024.

<sup>6</sup> Email datë 10.7.2024.

<sup>7</sup> Email datë 24.7.2024.

<sup>8</sup> Email datë 26.7.2024: “Komisioni - Konfirmim lidhur me vullnetin e pavesuar për t’u dorëhequr nga procesi rivlerësimit”.

<sup>9</sup> Email datë 27.7.2024 “Re: Komisioni - Konfirmim lidhur me vullnetin e pavesuar për t’u dorëhequr nga procesi rivlerësimit”.

e datës 10.7.2024”. Gjithashtu shprehet se: “...për arsye objektive nuk do të marr pjesë në seancën dëgjimore”.

## II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

**16.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**17.** Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës parashikon se: “[...] procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët [...] të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet [...]”. Ndërsa, neni 166, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, parashikon se: “[...] kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit personat, të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet ose personat që kanë ushtruar funksionin e magjistratit për 9 vjet, në 20 vitet e fundit [...]”. Në vijim, në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: “[...] subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”.

**18.** Referuar nenit 31, pika 3, nenit 35, pika 3 dhe nenit 41, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, i parashikuar në nenin 179/b, pika 4 të Kushtetutës, konkretisht ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet dhe kërkojnë të kthehen në sistemin e drejtësisë, kanë detyrimin të paraqesin brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe formularin e vetëvlerësimit profesional pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale. Dorëzimi i këtyre deklaratave është pikënisja e procesit të rivlerësimit për secilin subjekt të parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, përfshirë këtu edhe ata që nuk ishin në ushtrim detyre dhe aspirojnë që të riktheheshin në detyrë.

**19.** Në rastin konkret, rezulton se Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 21/2024 ka vendosur se kërkuesi Besnik Maho e plotëson kriterin kushtetues të vjetërsisë të paktën 3 vjet të ushtrimit të detyrës si gjyqtar.

**20.** Për sa i përket dorëzimit në kohë të deklaratës *Vetting*, trupi gjykues, pasi u njoh me shkresën e ILDKPKI-së<sup>10</sup>, me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.6.2024 çmoi se kërkuesi ka paraqitur në kohë deklaratën *Vetting* sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, çmoi se subjekti ka paraqitur në kohë formularin e vetëvlerësimit profesional bashkë me dokumentacionin shoqërues pranë ish-KLD-së<sup>11</sup>, si dhe ka paraqitur brenda afatit ligjor deklaratën për kontrollin e figurës pranë ish-DSIK-së<sup>12</sup>.

**21.** Sa më lart, kërkuesi Besnik Maho, duke plotësuar kriteret kushtetuese të parashikuara nga neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 84/2016, ka fituar statusin e “subjektit rivlerësues” dhe i nënshtrohet të drejtave e detyrimeve të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2024.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2023, e KLGJ-së.

<sup>12</sup> Sekret.

**22.** Bazuar në vendimin orientues nr. 1 (JR), datë 11.6.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, trupi gjykues verifikoi: (i) vullnetin e lirë e të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqje; (ii) rrethanat konkrete nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit; (iii) vlerësoi zbatimin e plotë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

#### **i) Vullneti i lirë e i pavesuar i subjektit të rivlerësimit për dorëheqje**

**23.** Në rastin konkret rezulton se në datën 4.7.2024 nga shërbimi postar është depozituar në protokollin e Komisionit kërkesa e datës 28.6.2024, e subjektit Besnik Maho, me objekt “Dorëheqje nga procesi i rivlerësimit si ish-gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

**24.** Nga shqyrtimi i kërkesës së mësipërme vërehet se subjekti ka parashtruar pretendime për shkelje të procesit të rregullt ligjor nga Komisioni gjatë fazës së hetimit administrativ në lidhje me mënyrën e administrimit dhe analizimit të provave, përmbajtjes dhe arsyesimit të vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të shumicës së anëtarëve të Komisionit, pretendime të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 21, datë 13.5.2024. Më tej, shprehet se një arsye tjetër që po jep dorëheqjen lidhet me faktin se interesat e tij jetësore, familjare dhe profesionale i realizon jashtë vendit, ndaj nuk ka asnjë interes profesional për momentin që të bëhet pjesë e sistemit gjyqësor. Në përfundim, kërkon dorëheqjen nga procesi i rivlerësimit si ish-gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

**25.** Në vijim, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të shfaqur vullnetin e tij të pavesuar për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit në seancë dëgjimore ose nëpërmjet postës elektronike, subjekti<sup>13</sup> ka deklaruar se: *“Vullnetin tim të lirë dhe të pavesuar, por që nuk pasqyrohet asnjëherë tërësisht në vendimmarrjet që janë marrë dhe do të merren, lidhur me kërkimet/qëndrimet që unë mbaj, është i plotë dhe shterues si në kërkesën me shkrim të datës 26.6.2024, ashtu edhe në email-in e datës 10.7.2024”*.

**26.** Sa më lart, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit Besnik Maho ka shprehur në mënyrë të qartë e të pavesuar vullnetin e tij për t’u dorëhequr nga procesi i rivlerësimit.

#### **ii) Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**27.** Neni 55 i ligjit 84/2016 parashikon se: *“1. Komisioni fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Vëzhguesit ndërkombëtarë njoftohen paraprakisht për zhvillimin e seancës dëgjimore”*.

**28.** Referuar rasteve të parashikuara nga neni 89<sup>14</sup> i Kodit të Procedurave Administrative dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>15</sup>, rrethanat e rastit në fjalë nuk e klasifikojnë atë si një nga rastet e përcaktuara shprehimisht, ku procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, për këto arsye:

<sup>13</sup> Email datë 27.7.2024.

<sup>14</sup> Kodi i Procedurave Administrative parashikon: *“Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme: a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t’i shkaktohet për shkak të vonesës interesit publik; b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative; c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës; ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur d) është parashikuar shprehimisht me ligj.*

<sup>15</sup> Vendimet nr. 1/2018, nr. 5/2018, nr. 17/2019 etj.

- a. Nuk përmbushen kushtet e parashikuara nga shkronja “a” e nenit 89 të sipërcituar, pasi nuk identifikohet asnjë nevojë/urgjencë në vendimmarrjen për rastin në fjalë, si pasojë e dëmit që mund t’i shkaktohet interesit publik.
- b. Nuk përmbushen kushtet e shkronjës “b” të të njëjtit nen pasi, pavarësisht se subjekti ka depozituar pranë Komisionit kërkesën me shkrim të aktit të dorëheqjes dhe e ka konfirmuar nëpërmjet postës elektronike, akti i dorëheqjes nuk bazohet në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, por i referohej vetëm nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.
- c. Nuk përmbushen kushtet e parashikuara nga shkronja “c” e nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi dorëheqjes së subjektit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës i atribuohen efekte ligjore negative në raport me të drejtat e tij për karrierë në sistemin e drejtësisë.
- d. Ndërsa, sa u takon shkronjave në vijim, “ç” dhe “d” të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, ato janë të pazbatueshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**29.** Sa më lart, Komisioni, në datën 26.7.2024, përmes postës elektronike, e ka ftuar subjektin për të shfaqur vullnetin e tij të pavesuar për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit në seancë dëgjimore dhe nëse nuk dëshiron të paraqitet, ta shprehë edhe një herë vullnetin e tij nëpërmjet postës elektronike.

**30.** Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti përmes postës elektronike<sup>16</sup> ka konfirmuar se vullneti i tij është i plotë dhe shterues si në kërkesën me shkrim të datës 26.6.2024, ashtu edhe në *email-in* e datës 10.7.2024 dhe deklaroi se: “...për arsye objektive nuk do të marr pjesë në seancë dëgjimore”.

**31.** Në kushtet kur subjekti nuk kërkon të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 88, pika 3 e Kodit të Procedurave Administrative, trupi gjykues çmoi të mos mbajë seancë dëgjimore, por të vijojë me marrjen e vendimit përfundimtar, mbi bazë dokumentesh.

### **iii) Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit**

**32.** Një nga shkaqet kushtetuese për moskalimin me sukses të procesit të rivlerësimit është edhe instituti i “dorëheqjes”, i sanksionuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet”. Dorëheqja në vetvete, e trajtuar posaçërisht nga Kushtetuta, nuk është shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sikurse nuk përbën shkak për konfirmimin në detyrë dhe, si e tillë, Kushtetuta e ka shoqëruar pandashmërisht edhe me përcaktimin negativ të drejtash, siç është ndalimi i ushtrimit të profesionit. Pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës sanksionon: “2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet..., nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”<sup>17</sup>.

**33.** Aspektet procedurale të dorëheqjes së subjekteve në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 parashikohen në nenin 56<sup>18</sup> të ligjit nr. 84/2016, ndërsa

<sup>16</sup> Email datë 27.7.2024.

<sup>17</sup> Vendim nr. 1/2018 (JR) i Kolegjit (paragrafi 63).

<sup>18</sup> Neni 56 parashikon: “1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit”.

për subjektet e parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, që i nënshtrohen me kërkesë procesit të rivlerësimit, ligji nuk ka parashikuar ndonjë procedurë konkrete. Megjithatë, ligji nr. 84/2016, në nenin 58<sup>19</sup> ka parashikuar masat disiplinore për procesin e rivlerësimit si për subjektet që kanë qenë në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ashtu edhe për ish-gjyqtarët/prokurorët apo ish-ndihmësit ligjorë, të cilët janë bërë subjekte rivlerësimi me kërkesën e tyre.

**34.** Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>20</sup> në jurisprudencën e tij orientuese, ndërmjet të tjerave, arsyeton se: *“Masat disiplinore të përcaktuara me ligj në procesin e rivlerësimit, në përfundim të procesit, sipas kategorisë së subjekteve të rivlerësimit mund të ndahen në 3 (tri) grupime: 1. për magjistratët në detyrë, që janë të emëruar dhe të caktuar: a) konfirmimi në detyrë; b) shkarkimi nga detyra; c) pezullimi; 2. për ish-gjyqtarët/prokurorët, që kërkojnë të emërohen dhe të caktohen në detyrë: a) emërimi si gjyqtar ose prokuror; b) refuzimi i emërimit si gjyqtar ose prokuror. Në drejtim të arritjes së qëllimit të saj, vetë Kushtetuta, me bazë prezumimin në favor të masës disiplinore, ka përcaktuar edhe ndalimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

**35.** Bazuar në këto konsiderata të pranuar nga Kushtetuta dhe të materializuara edhe nga ligji i posaçëm, vijon arsyetimin orientues Kolegji, dorëheqja gjatë procesit të rivlerësimit përbën shkak për ndalim “kufizimin e të drejtës së emërimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”, prandaj mungesa e përcaktimit në dispozitivin e vendimit mund të përbëjë shkak për pretendimin e mohimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

**36.** Në vijim të arsyetimit të paragrafit të mësipërm, Kolegji<sup>21</sup> është shprehur se: *“Ndalimi i shprehur në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk përbën kompetencë për vendimmarrje, por është pasojë që ligji krijon për dorëheqjet nga subjekte që zgjedhin të ushtrojnë këtë mjet procedural që garanton ndërprerjen e rivlerësimit, i cili në mungesë të dorëheqjes do t'i nënshtrohej ex officio procesit të rivlerësimit. Komisioni në këtë aspekt nuk ushtron asnjë aktivitet diskrecional, por ka për detyrë të pasqyrojë pasojën që parashikon pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.*

**37.** Në rastin konkret rezulton se ish-gjyqtari Besnik Maho është bërë subjekt rivlerësimi me kërkesën e tij. Më tej, Komisioni e ka njoftuar subjektin në datën 13.1.2021, me anë të postës elektronike<sup>22</sup>, për fillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe i ka kërkuar të kthejë përgjigje për pyetësonin standard. Në përgjigje<sup>23</sup>, subjekti ka njoftuar Komisionin për tërheqjen nga procesi

---

<sup>19</sup> Neni 58 parashikon: *“Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: a) konfirmimin në detyrë; b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; c) shkarkimin nga detyra.*

*2. Në rast se subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë: a) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve; b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.*

<sup>20</sup> Vendim nr. 1/2018 (JR) i Kolegjit (paragrafët 83-84).

<sup>21</sup> Vendim nr. 5 (JR), datë 10.9.2018 (paragrafi 24).

<sup>22</sup> Email datë 13.1.2021, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

<sup>23</sup> Email datë 28.1.2021.

i *Vetting*-ut, me arsyen se ka marrë pjesë në konkurrimin për inspektor pranë ILD-së nga radhët e subjekteve jo magjistratë.

**38.** Më pas, përmes postës elektronike<sup>24</sup>, subjekti ka revokuar kërkesën e tij për tërheqje nga procesi i rivlerësimit dhe ka shfaqur interesin të vazhdojë procesin e rivlerësimit.

**39.** Në vijim, gjatë komunikimit me Komisionin lidhur me dorëzimin në kohë të deklaratës *Vetting*, subjekti<sup>25</sup> është shprehur se e ka dorëzuar në kohë deklaratën *Vetting*, duke paraqitur dokumentacionin provues.

**40.** Komisioni me vendimin nr. 714, datë 15.11.2023, vendosi të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për kërkuesin Besnik Maho, me arsyetimin se nuk është në rrethin e personave të përfshirë në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, për shkak se nuk ka punuar të paktën 3 vite në pozicionin e gjyqtarit. Kundër vendimit të Komisionit subjekti paraqiti ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, duke pretenduar se plotësonte kriterin kushtetues të ushtrimit të detyrës për 3 vite dhe i ka kërkuar Kolegjit dhënien e të drejtës kushtetuese dhe ligjore për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Kolegji me vendimin nr. 21/2024 ka vendosur se kërkuesi Besnik Maho e plotëson kriterin kushtetues të vjetërsisë të paktën 3 vite të ushtrimit të detyrës si gjyqtar dhe ka urdhëruar Komisionin të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar.

**41.** Sa më lart, vërehet se subjekti ka shprehur në mënyrë të qartë e vazhduese vullnetin e tij për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si përpara Komisionit, ashtu edhe përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**42.** Më tej, pasi i është njohur e drejta si subjekt rivlerësimi me vendimin nr. 21/2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.6.2024 të trupit gjykues të Komisionit, është njoftuar nga Komisioni<sup>26</sup> për vijimin e procesit të rivlerësimit, si dhe për kthimin e përgjigjeve të pyetësorit standard. Në përgjigje, subjekti ka paraqitur nëpërmjet shërbimit postar kërkesën e datës 28.6.2024 për dorëheqjen nga procesi i rivlerësimit, kërkesë të cilën e ka konfirmuar edhe nëpërmjet postës elektronike<sup>27</sup>.

**43.** Sa më lart, trupi gjykues çmon se paraqitja e aktit të dorëheqjes i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit, duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme. Por, nga ana tjetër, në kushtet kur ish-gjyqtari Besnik Maho është bërë subjekt rivlerësimi me kërkesë të tij dhe kishte shprehur në mënyrë të qartë e vazhduese vullnetin e tij për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, duhet t'i kishte të qarta pasojat dhe efektet juridike që do të sillte moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, sikurse është refuzimi i emërimit si gjyqtar bashkë me pasojën që e shoqëron sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, atë në kufizimin e të drejtës së emërimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

**44. Në përfundim,** trupi gjykues vlerëson se ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure

---

<sup>24</sup> Email datë 6.5.2021, email datë 14.5.2021.

<sup>25</sup> Email datë 18.5.2021, email datë 25.5.2021.

<sup>26</sup> Email datë 26.6.2024.

<sup>27</sup> Email datë 27.7.2024.



administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 57 e 58 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në shkronjën "b" të nenit 89 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Maho, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
2. Ndalimin e emërimit të z. Besnik Maho gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.9.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*